

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil,** në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi **Drilon HARAÇIA** - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të paditëses – propozueses A. I., e lindur V. nga Gjakova, të cilën e përfaqëson F. B. nga Gjakova, me autorizim në lëndë, kundër të paditurit - propozuesit D. I. nga Gjakova, te cilin e përfaqëson I. K. nga Gjakova me autorizim në lëndë, për zgjidhjen e martesës, në seancën kryesore jo publike, të mbajtur **me dt.24.04.2017** në prezencën e paditëses - propozueses dhe të autorizuarit të saj dhe të autorizuarit të paditurit - propozuesit, mori këtë;

### **A K T G J Y K I M**

**ZGJIDHET** martesë me marrëveshje në mes të propozueses A. (M.) I., e lindur V. nga Gjakova dhe propozuesit D. (R.) I. nga Gjakova, e lidhur me datën 30.10.2007 në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, nën numrin rendor 809, me numër të referencës 2/2007RM/2001, në kuptim të nenit 68 pika 1, të Ligjit për Familjen të Kosovës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### **A r s y e t i m**

Paditësja nëpërmjet të autorizuarit të saj pranë kësaj Gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit të lartcekur, duke theksuar se paditësja dhe i padituri, kanë lidhur kurorë ligjore në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë me datë 30.10.2007, nën numër të referencës 2/2007RM/2001, me numër rendor 809. Paditësja dhe i padituri faktikisht nuk kanë jetuar fare ne mes vete dhe vetëm kanë lidhur kurorë në Gjakovë dhe i padituri pastaj ka shkuar në botën e jashtme në adresë të panjohur dhe nuk është lajmëruar kurrë më dhe paditësja nuk ka informacione fare se ku gjendet i padituri. Me që kanë kaluar shumë vite dhe paditësja dhe i padituri nuk kanë fare komunikim, martesës i ka humbur efekti andaj paditësja dëshiron që të njëjtën të e zgjidhë. Pra paditësja dhe i padituri nuk kanë jetuar në mes vete dhe formalisht kanë lidhur martesë duke shpresuar se paditësja do të shkon për të jetuar jashtë.

I autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë propozimit, zgjidhjes së martesës me marrëveshje. Po ashtu i autorizuari i propozueses në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas shqyrtimit të provave materiale me pa mëdyshje u vërtetua se në mes të bashkëshortëve gjer me tani është bërë ndërprerja faktike e jetës bashkëshortore dhe i propozojmë Gjykatës që edhe me Aktgjykim ta konsideroi si të zgjedhur martesën e cekur si më lartë.

- Shpenzime nuk kërkoi dhe heqim dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës në rast të aprovimit nga ana e Gjykatës.

I autorizuari i të paditurit ka deklaruar se pajtohet me deklaratimet e të autorizuarit të paditëses duke shtuar se ka marrë konfirmimin nga i padituri që martesë të zgjidhet me marrëveshje, pasi që të njëjtë nuk kanë jetuar asnjë ditë bashkë. Po ashtu i autorizuari i propozuesit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pajtohem me deklaratimet e të autorizuarit të propozueses që të bëhet zgjidhja e martesës me marrëveshje, andaj propozoi Gjykatës që të njëjtën ta aprovoi.

- Shpenzime nuk kërkoi dhe heqim dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës në rast të aprovimit nga ana e Gjykatës.

Gjykata lidhur me propozimin e të autorizuarit të paditëses dhe aprovimin nga i autorizuari i të paditurit që padia të konsiderohet si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës, Gjykata mori

Aktvendim duke e miratuar propozimin e të autorizuarit të palëve ndërgjygjëse që padia të trajtohet si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës, në kuptim të nenit 68.4 të LFK-së.

Procedura e pajtimit nuk është zhvilluar pasi që pala e paditur gjendet në botën e jashtme.

Gjykata në procedurën e administrimit të provave ka bërë shikimin dhe leximin e Certifikatës së martesës së propozuesve me numër serik M10346183, numër rendor 809, me numër të referencës 2/2007RM/2001, të lëshuar nga Zyra gjendjes civile në Gjakovë me dt.24.04.2017 dhe pas vlerësimit të fakteve juridike – relevante të kësaj çështje, çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave të administruara, rrethanave jo kontestuese të palëve, në kuptim të nenit 8 të LPK, e miratoj propozimin për zgjidhjen e martesës bazuar edhe në nenin 68 pika 1, të Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr.2004/32 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” nr.4, të dt.01.09.2004, në tekstin e mëtejme LFK).

Nga provat e administruara u argumentua kjo gjendje faktike:

Nga Certifikata e martesës me numër serik M 10346183, me numër rendor 809, me numër të referencës 2/2007RM/2001, të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Gjakovë me dt.24.04.2017, rezulton se palët kanë lidhur martesë me datën 30.10.2007 dhe nga kjo martesë nuk kanë fëmijë.

Gjykata në rastin konkret konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 69 pika 1, 2 dhe 4 të LFK, sepse martesë e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë. Është fakt se martesë lidhet në bazë të dashurisë, simpatisë, besnikërisë dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Mirëpo, meqë në rastin konkret këto elemente qenësore mungojnë, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit të para cituar, ku janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit si shkaqe të përgjithshme dhe shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit të përcaktuara me nenin 69 par.1 të LFK, parasheh se bashkëshortet mund të e kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioze të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë; xhelozia, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme. Ndërsa shkaqet e veçanta janë të parapara në nenin 69 par.2 të LFK, ku përcaktohen si; jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike, sëmundja psikike e pa shërueshme etj. Pra, në rastin konkret kjo bashkësi martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr konform nenit 449.1 lidhur me nenin 450 të LPK-së, dhe deklarimit të palëve në procedurë.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C.nr.118/17 dt.24.04.2017**

**KRYETARI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYKATËSI,**  
**Drilon HARAÇIA**

**UDHËZIM JURIDIK;** Ky Aktgjykim është i formës së prerë pasi që palët në procedurë kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.